



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 9 qershor 2023
Nr. ref.:RK 2205/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI86/22

Parashtrues

Pjetër Boçi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit Pml. nr. 151/2022 të 14 prillit 2022
të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Pjetër Boçi, me vendbanim në Prizren (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Pml. nr. 151/2022] të 14 prillit 2022 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në ndërlidhje me Aktvendimin [PN. nr. 1206/2021] e 8 dhjetorit 2021 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [PK. nr. 132/21] e 8 tetorit 2021 të Gjykatës Themelore në Prizren.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, më të cilin parashtruesi i kërkesës në substancë pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa Individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 21 qershor 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 23 qershor 2022, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin GJR. KI86/22, caktoi gjyqtaren Selvete Gërzhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe me Vendimin KSH. KI86/22 caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
7. Më 24 qershor 2022, Gjykata për regjistrimin e kërkesës e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
8. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
9. Më 27 dhjetor 2022, Gjykata nga Gjykata Themelore në Prizren kërkoi fletëkthesën si dëshmi e datës së pranimit të Aktgjykimit [Pml. nr. 370/2021] të 4 nëntorit 2021 të Gjykatës Supreme nga parashtruesi i kërkesës.
10. Më 10 janar 2023, Gjykata Themelore në Prizren informoi Gjykatën se Aktgjykimi [Pml. nr. 370/2021] i 4 nëntorit 2021 i Gjykatës Supreme, i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 2 dhjetor 2021.
11. Më 25 maj 2023, Gjykata shqyrtoi raportin paraprak të propozuar nga gjyqtarja raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

Historiku

12. Më 4 maj 2011, parashtruesi i kërkesës ishte intervistuar nga Policia e Krimeve Ekonomike në Prizren dhe pas intervistimit, i njëjti me urdhër të Prokurorit u ndalua në mbajtje nga 19 maji 2011, deri më 11 korrik 2011. Prokuroria e Qarkut në Prizren, më 21 maj 2011, në lidhje me këtë rast nisi hetimet kundër parashtruesit të kërkesës (dhe disa personave të tjerë), nën dyshimin e arsyeshëm se gjatë kohës sa i njëjti punonte si Instruktor në një autoshkollë në Prizren, kishte kryer veprat penale nga nenet, 343 [Marrja e Ryshfetit], 332 [Falsifikimi i Dokumenteve], 274 [Krimi i Organizuar] dhe 23 [Bashkëkryerja] të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK). Prokuroria e Qarkut në ndërkohë kishte pushuar hetimet ndaj parashtruesit të kërkesës, sa i përket veprave penale nga neni 274 [Krimi i Organizuar] dhe 23 [Bashkëkryerja], me arsyetimin se nuk ekzistonte dyshimi i arsyeshëm, që parashtruesi i kërkesës të ketë kryer këto vepra penale. Pas kësaj periudhe, gjegjësisht më 17 mars 2014 Prokuroria Themelore në Prizren, kishte ngritur aktakuzën [PP. nr. 3409/11-II], ndaj parashtruesit të kërkesës, nën dyshimin e bazuar se i njëjti kishte kryer veprat penale nga nenet 343 [Marrja e Ryshfetit] dhe 345 [Ushtrimi i Ndikimit] të KPRK-së.
13. Parashtruesi i kërkesës në lidhje me çështjen penale parashtron për herë të tretë kërkesë në Gjykatë. Më parë kishte parashtruar kërkesat KI76/18 dhe KI21/19. Nëpërmjet kërkesës së parë KI76/18, parashtruesi i kërkesës kontestoi Aktgjykimin [PML. nr. 279/2017] e 26 marsit 2018 të Gjykatës Supreme dhe Aktvendimin [PN. nr. 462/2018] e 28 majit 2018 të Gjykatës së Apelit. Këtë kërkesë Gjykata, e kishte deklaruar të papranueshme me Aktvendimin e 22 nëntorit 2018, pasi kishte analizuar pretendimet përkitazi me (i) ngritjen e aktakuzës pa bazë ligjore, (ii) aplikimin e dispozitave penale në lidhje me dëfinimin e termit “person zyrtar” dhe (iii) me rishikimin e procedurës penale. Ndërsa, nëpërmjet kërkesës së dytë KI21/19, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar interpretimin e legjislacionit relevant në lidhje me dëfinimin e “pozitës zyrtare” në lidhje me të cilën Gjykata vendosi më 27 maj 2019, me Aktvendim për papranueshmëri, pasi konstatoi se i njëjti nuk ishte palë e autorizuar, për të ngritur një kërkesë të tillë në Gjykatë.
14. Duke qenë se kërkesat për rishikimin e rastit penal, ndaj Aktgjykimit të formës së prerë [P. nr. 206/2015] të 7 dhjetorit 2016 të Gjykatës Themelore në Prizren, janë objekt trajtimi edhe në kërkesën e tanishme KI86/22, Gjykata në mënyrë të përmbledhur do t'i reflektojë faktet e rastit KI76/18, nëpërmjet të cilit ishte trajtuar kërkesa e I (parë) e parashtruesit të kërkesës për rishikimin e procedurës penale të përfunduar me aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore.

Përmbledhje e shkurtër e fakteve të rastit KI76/18

15. Më 7 dhjetor 2016, Gjykata Themelore në Prizren, me Aktgjykimin P. nr. 206/2015, kishte: (i) liruar parashtruesin e kërkesës nga akuza për veprën penale “ushtrimi i ndikimit” dhe (ii) e kishte shpallur atë fajtor për kryerjen e veprës penale “marrja e ryshfetit”, për të cilën u dënua me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muajve. Ky aktgjykim ishte apeluar nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën e Apelit dhe kjo e fundit me Aktvendimin PAKR. nr. 70/17, kishte refuzuar ankesën e tij dhe kishte lënë në fuqi Aktgjykimin [P. nr. 206/2015] e 7 dhjetorit të Gjykatës Themelore. Ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, e cila me Aktgjykimin [Pml. nr. 279/2017] e 26 marsit 2018, e kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën e tij, duke konfirmuar përfundimisht aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët. Aktgjykimi [P. nr. 206/2015] i 7 dhjetorit 2016, i Gjykatës Themelore, në këtë rast ishte bërë i formës së prerë.

Kërkesa e I-parë për rishikimin e procedurës penale, e trajtuar me Kërkesën KI76/18

16. Më 31 dhjetor 2017, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesë për rishikimin e procedurës penale, në Gjykatën Themelore, ndaj aktgjyqimit përfundimtar të kësaj të fundit [P. nr. 206/2015] të 7 dhjetorit 2016, për shkak të paraqitjes së provave të reja. Më 10 maj 2018, Gjykata Themelore, me Aktvendimin [PK. nr. 157/2017], kishte hedhur poshtë kërkesën për rishikimin e procedurës penale, me konstatimin se nuk kishte prova të reja për aprovimin e një kërkesë të tillë. Ky aktvendim nga parashtruesi i kërkesës u apelua në Gjykatën e Apelit, e cila më 28 maj 2018, nxori Aktvendimin PN. nr. 462/2018 me të cilin refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe konfirmoi Aktvendimin [PK. nr. 157/2017] e 10 majit 2018 të Gjykatës Themelore, me arsyetimin se nuk ishin plotësuar kushtet ligjore për rishikimin e procedurës penale, siç me të drejtë kishte konstatuar shkalla e parë.
17. Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, me të cilin u refuzua kërkesa e I-parë për rishikimin e procedurës penale, u kontestua nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Kushtetuese, e cila me Aktvendimin e 22 nëntorit 2018, konstatoi se kërkesa në këtë pjesë nuk ishte *ratione materiae*, në pajtim me Kushtetutën.

Përmbledhje e fakteve të kërkesës së re KI86/22

Kërkesa e II-dytë për rishikimin e procedurës penale

18. Më 10 mars 2021, parashtruesi i kërkesës për herë të dytë, parashtrroi kërkesë për rishikimin e procedurës penale, të përfunduar me Aktgjykimin [P. nr. 206/15] të 7 dhjetorit 2016 të Gjykatës Themelore, me pretendimin se pas vuajtjes së dënimit ka gjetur se lidhur me rastin e tij penal, ekzistojnë prova të reja të cilat nuk ishin të njohura gjatë procedurës së rregullt penale, duke theksuar se është dënuar për një vepër penale e cila nuk ka ekzistuar në legjislacionin penal.
19. Më 24 mars 2021, Prokuroria Themelore, i propozoi Gjykatës Themelore që kërkesa për rishikimin e procedurës penale të hedhet poshtë si e paafatshme.
20. Më 19 prill 2021, Gjykata Themelore, me Aktvendimin PK. nr. 36/2021, hodhi poshtë si të paafatshme kërkesën e parashtruesit të kërkesës për rishikimin e procedurës penale, të përfunduar me Aktgjykimin [P. nr. 206/15] të 7 dhjetorit 2016 të Gjykatës Themelore, me arsyetimin se kërkesa ishte parashtruar pas dy vitesh dhe jo siç parashihej me nenin 418, paragrafin 1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës e Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPRK).
21. Parashtruesi i kërkesës, në afat ligjor, parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktvendimit [PK. nr. 36/2021] të 19 prillit 2021, për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, shkeljeve esenciale së dispozitave të procedurës penale, dhe aplikimit të gabuar të dispozitave të KPPRK-së.
22. Më 1 qershor 2021, Prokuroria e Apelit, i propozoi Gjykatës së Apelit, që ankesën e parashtruesit të kërkesës ta refuzojë si të pabazuar dhe ta konfirmojë Aktvendimin [PK. nr. 36/2021] e 19 prillit të Gjykatës Themelore.
23. Më 4 qershor 2021, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin PN. nr. 511/21, aprovoi si të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe Aktvendimin [PK. nr. 36/2021] e 19 prillit 2021 të Gjykatës Themelore, e kthen në rivendosje, me arsyetimin se në rastin konkret gabimisht janë zbatuar dispozitat e nenit 418 të Kodit 04/L-123 të KPPRK, e cila parasheh afate të përgjithshme për mjetet e jashtëzakonshme dhe se përkitazi me

rishikimin e procedurës penale, Gjykata Themelore është dashur t'i referohet nenit 423 të KPPRK-së, në të cilën në mënyrë taksative janë përcaktuar kushtet lidhur me këtë procedurë.

24. Më 25 qershor 2021, Gjykata Themelore, në riprocedurë nxori Aktvendimin PK. nr. 36/2021, me të cilin hodhi poshtë kërkesën për rishikimin e procedurës penale të parashtruesit të kërkesës, të përfunduar me Aktgjykimin [P. nr. 206/2015] e 7 dhjetorit 2016 të Gjykatës Themelore, me arsyetimin se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për aprovimin e një kërkesë të tillë. Në shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, kjo gjykatë theksoi se: *“pretendimi i dënuarit se neni 309 i KPRK-së (Kodi i ri Penal), nuk i inkriminon veprimet e tij në vitin 2011, pasi që gjatë asaj kohe nuk ka qenë person zyrtar, dhe në rastin konkret është dënuar për një vepër penale e cila nuk ka ekzistuar në legjislacionin penal, sipas konstatimit të kolegjit këto pretendime nuk mund të qëndrojnë pasi që Kodi Penal i Republikës së Kosovës (nr.06/L-074), ka hyrë në fuqi më 14 prill 2019, në rastin konkret ky kod, respektivisht dispozitat e këtij kodi nuk mund të gjejnë zbatim për veprën penale e cila është kryer në vitin 2011, pasi që dispozita e nenit 3 e kodit në fjalë, parasheh se ndaj kryerësit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, përjashtimisht nëse ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, ndaj kryerësit zbatohet ligji që është më i favorshëm, në këtë drejtim duke marrë parasysh këto dispozita ligjore dhe faktin se në kohën kur është kryer vepra penale ka qenë në fuqi KPP i vitit 2004, i cili veprimet e të dënuarit i ka inkriminuar si vepër penale e aq më tepër kur merret parasysh fakti se i dënuari e ka vuajtur dënimin e shqiptuar, pretendimet e tij janë tërësisht të pabazuara në ligj”*. Tutje, Gjykata Themelore, theksoi se: *“lidhur me pretendimin e ngritur nga i dënuari se asnjëherë nuk ka testuar kandidatë dhe se nuk ka pasur asnjëherë autorizime zyrtare pranë Ministrisë së Infrastrukturës, kjo nuk është ndonjë fakt i ri me të cilën do të arsyetonte i dënuari pafajësinë e tij, pasi që kjo provë nuk e bën të besueshëm se ngjarja ka ndodhur ndryshe në krahasim me mënyrën se si është vendosur me aktgjykimin e formës së prerë”*.
25. Parashtruesi i kërkesës, në afat ligjor, parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit [PK. nr. 36/2021] të 25 qershorit 2021 të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe aplikim të gabuar të ligjit penal.
26. Më 30 korrik 2021, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin PN. nr. 653/2021, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe konfirmoi Aktvendimin [PK. nr. 36/2021] e 25 qershorit të Gjykatës Themelore.
27. Parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër Aktvendimit të 30 korrikut 2021 të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale, dhe aplikimit të gabuar të dispozitave të së drejtës materiale.
28. Më 4 nëntor 2021, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Pml. nr. 370/2021, refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se gjykatat e instancës me të ulët, drejtë kanë zbatuar dispozitat ligjore të aplikueshme, kur kanë refuzuar kërkesën për rishikimin e procedurës penale, bazuar në mungesën e provave të reja.

Kërkesa e III-tretë për rishikimin e procedurës penale

29. Parashtruesi i kërkesës, ende pa përfunduar procedura në shkallë të tretë, përkitazi me kërkesën e dytë të rishikimit të procedurës penale, parashtrroi një kërkesë të tretë për rishikimin e procedurës penale, e cila kishte përfunduar me aktgjykimin e formës së

prerë [P. nr. 206/2015] të 7 dhjetorit 2016 të Gjykatës Themelore, sërish me pretendimin se kishte prova të reja për vendosjen ndryshe të rastit.

30. Më 8 tetor 2021, Gjykata Themelore, me Aktvendimin [PK. nr. 132/21], hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për rishikimin e procedurës penale të përfunduar me Aktgjykimin përfundimtar të 7 dhjetorit 2016 të Gjykatës Themelore, me arsyetimin se nuk kemi të bëjmë me prova të reja në bazë të të cilave do të lejohej rishikimi i procedurës penale, të përfunduar me Aktgjykimin e formës së prerë të 7 dhjetorit 2016 të kësaj gjykate.
31. Parashtruesi i kërkesës, kundër këtij aktvendimi parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të (i) shkeljes së parimeve themelore të KPPRK-së dhe (ii) vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që ankesa e tij të aprovohej dhe të mundësohej rishikimi i procedurës penale të përfunduar me Aktgjykimin [P. nr. 206/15] e 7 dhjetorit 2016 të Gjykatës Themelore. Në ankesë, parashtruesi i kërkesës theksoi se: *“gjykata e shkallës së parë ka shkelur procedurën penale se në fillim lëndën do ta dërgonte në Gjykatën Supreme. Kështu, theksohet se i dënuari Pjetër ka bërë kërkesë për rishikim të procedurës penale me provë të re me datë 13.08.2021, por këtë e ka bërë për t'i paraprirë kërkesës së Kryetarit të Gjykatës së Apelit për përjashtimin e ushtruesit të detyrës së Kryetarit të Gjykatës dhe duke i lajmëruar se fillimisht do të bëjë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme , për çka edhe ka bërë kallëzim penal. Si provë, bashkëngjit kallëzimin penal për A.S. Gjithashtu, konsideron se dëshmohet qartë qëllimi për ta dëmtuar procesin e rishikimit, duke mos e dërguar në Gjykatë Supreme. Sipas ankesës, ushtruesi i detyrës së Kryetarit të Gjykatës A.S, ka caktuar kryetar dhe anëtarët e kolegjit për rishikim të procedurës penale në kundërshtim me nenin 39, par.2 të KPP-së. I dënuari, njofton se ka bërë kërkesë për përjashtimin e U.D. së kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren”.*
32. Më 6 dhjetor 2021, Prokuroria e Apelit i propozoi Gjykatës së Apelit që ankesa e parashtruesit të kërkesës të refuzohej si e pabazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar të mbetej në fuqi.
33. Më 8 dhjetor 2021, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin [PN. nr. 1206/2021], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke e konfirmuar si të drejtë Aktvendimin [PK. nr. 132/21] e 8 tetorit 2021 të Gjykatës Themelore, duke theksuar se: *“ankesa nuk është shoqëruar me provë që kishte për të vërtetuar se i njëjti është përjashtuar apo jo sipas kësaj kërkesë”.*
34. Përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni [39] i KPPRK-së, Gjykata e Apelit theksoi se të njëjtat: *“janë të pabazuara për faktin se i dënuari pretendon se ka paraqitur kërkesë për përjashtim ndaj D.D Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren, e cila kërkesë vendoset nga Kryetari i Gjykatës së Apelit por se shkresat e lëndës përkitazi me këtë tregojnë se nuk ka prova që do të dëshmonin këtë fakt, nëse ai ishte përjashtuar apo jo. Në anën tjetër sipas pretendimit të ankesës përkitazi me bazën ligjore të nenit 39, par.1 par.2 të KPP-së për përjashtim, kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit sipas këtij neni vendoset nga Kryetari i Gjykatës Themelore, dhe kërkesa për përjashtim ka të bëjë vetëm me gjyqtarin që e trajton çështjen, e që në rastin konkret me aktvendimin e 'ankimuar për hedhjen e kërkesës së të dënuarit ka vendosur Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: R. E, kryetare, V.B dhe F.K, anëtarë, për të cilët nuk figuron të jetë bërë ndonjë kërkesë për përjashtim nga ana e të dënuarit, e as pretendimet ankimore të dënuarit nuk kanë të bëjnë me këta gjyqtarë”.*
35. Përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me bashkëngjitjen e kallëzimit penal në ankesë ndaj ushtruesit të detyrës të Kryetarit të Gjykatës Themelore

në Prizren, A. S., si dhe dy gjyqtarëve të tjerë të asaj gjykate, Gjykata e Apelit të njëjtat i konsideroi si të pabazuara, duke theksuar se përkundër faktit se paraqitja e kallëzimit penal është e drejtë e çdo personi, siç parasheh dispozita e nenit 79 të KPPRK-së, megjithatë i mbetet Prokurorit të Shtetit të ndërmerë më tutje veprimet hetimore dhe të vendos përkitazi me rezultatet e hetimet, andaj Gjykata e Apelit vlerësoi se nuk është plotësuar kushti sipas dispozitës ligjore të nenit 423.1 të KPP-së.

36. Parashtruesi i kërkesës, i pakënaqur me aktvendimin e lartcekur parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që kërkesa e tij të aprovohet dhe aktvendimet e kundërshtuara të anulohen.
37. Më 12 prill 2022, Prokurori i Shtetit, nëpërmjet parashtrësës [KMLP. II. nr. 97/2022], i propozoi Gjykatës Supreme që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, e parashtruesit të kërkesës të refuzohet si e pabazuar.
38. Më 14 prill 2022, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin e kontestuar [Pml. nr. 151/2022], e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së parashtruesit të kërkesës, të ushtruar kundër Aktvendimit [PK. nr. 132/2021] të 8 tetorit 2021 të Gjykatës Themelore dhe Aktvendimit [PN. nr. 1206/2021] të 8 dhjetorit 2021 të Gjykatës së Apelit, me arsyetimin se aktvendimet e kontestuara të instancave më të ulëta nuk përmbajnë shkelje të ligjit penal dhe procedural, siç kishte pretenduar parashtruesi i kërkesës. Për më tepër, Gjykata Supreme, konstatoi se: *“në kërkesën e të dënuarit pretendohet se parregullsitë ligjore në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë të asaj natyre që e arsyetojnë kthimin, për sa u përket problemeve ligjore që kanë lindur gjatë gjyimit të çështjeve me objekt të rishikimit të vendimeve penale të formës së prerë, për shkak se dy gjykatat nuk kanë shqyrtuar mjaftueshëm kërkesat dhe argumentet e paraqitura nga i dënuari. Gjykatat nuk kanë analizuar në detaje bazat dhe arsyetimin e vendimit të ankimuar përfshirë vendimin mbi dënimin, mbi një interpretim të saktë të ligjit dhe të një gjykimi dhe vlerësimi mbi provat në mënyrë të drejtë. Tutje në kërkesë pretendohet se i njëjti në raport me 5 të akuzuarit tjerë në këtë çështje të cilët ishin të veshur me attribute të personit zyrtar sipas ligjit, i dënuari Pjetër Boqi, nuk i kishte këto attribute minimale zyrtare dhe sipas gjykatës doli të jetë më me shumë rrezikshmëri shoqërore, i cili duhet të vuante dënimin me burgim. Po ashtu pretendon se Gjykata Themelore në Prizren, nuk sqaroi me hollësi së pari se pse fakti se i dënuari ka vuajtur dënimin konsiderohet si një tregues i rëndësisë së veçantë për të konsideruar kërkesën si tërësisht të pabazuar me ligj”.*
39. Gjykata Supreme vlerësoi se: *“kërkesa e të dënuarit për rishikim të procedurës penale është e pabazuar, pasi që edhe gjykatat e instancës më të ulët kanë vlerësuar drejtë se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për rishikimin e procedurës penale nga neni 423, par. 1 të KPPK-së, pasi që në kërkesën për rishikimin e procedurës penale nuk është prezantuar asnjë fakt apo provë e re e cila ka qenë e panjohur për gjykatat në momentin e marrjes së aktgjykimeve, ndërsa rishikimi i procedurës penale lejohet vetëm nëse zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja, të cilat së bashku me provat e mëparshme ka të ngjarë të arsyetojnë pafajësinë e personit të dënuar ose dënimin e tij sipas një dispozite më të butë penale. Andaj, pretendimet e paraqitura nga i dënuari, në kërkesë për rishikimin e procedurës penale, nuk kanë vlerë provuese dhe janë të parëndësishme në këtë çështje penalo-juridike, për këtë arsye edhe nuk është gjetur bazë për lejimin e rishikimit të procedurës penale”.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

40. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, shkel të drejtat dhe liritë themelore të tij, pa specifikuar shprehimisht ndonjë nen konkret të

Kushtetutës, por që në substancë ka ngritur çështje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për një Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

i. Pretendime përkitazi me "parregullsinë e procesit"

41. Parashtruesi i kërkesës, pretendon se aktakuza [PP.nr.3409/11-II] ndaj tij është ngritur me shkelje të ligjit penal, sepse: *"Kodi Penal i Kosovës e përcakton saktësisht se kush është "Person zyrtar" edhe në Kodin e vjetër penal, edhe në Kodin e ri penal. Të njëjtën punë ka bërë edhe Gjykata Themelore në Prizren, duke bërë shkelje esenciale të ligjit penal nga neni 384, paragrafi 1 i këtij kodi"*.
42. Mbi këtë bazë, parashtruesi i kërkesës i referohet Mendimit Juridik të 29 shtatorit 2016 të Gjykatës Supreme, ku sipas tij thuhet se (I) Prokurori i Shtetit, brenda 30 ditësh duhet të vendosë për informacione shtesë, për aplikimin eventual të masave të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit, hedhjen e kallëzimit penal, apo për fillimin e hetimit, dhe (II) nëse pas dorëzimit të kallëzimit penal të policisë, policia mëson fakte të reja ose nxjerr prova apo gjurmë të veprës penale, ajo detyrohet që vazhdimisht të mbledhë informata të nevojshme dhe për këtë, menjëherë duhet t'ia dorëzojë Prokurorit të Shtetit, raportin plotësues të kallëzimit penal të policisë.
43. Tutje, duke iu referuar Mendimit juridik të Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës thekson: *"me qëllim të respektimit të standardit për gjykim në një afat të arsyeshëm dhe për siguri juridike, ligjdhënësi i ka limituar në aspektin kohor veprimet e policisë "brenda 24 orësh duhet ta dorëzojnë kallëzimin penal", veprimet e prokurorit "që brenda 30 ditëve ta hedh kallëzimin penal", e nëse se hedh kallëzimin penal, duhet që brenda 24 muajve, me vazhdim të mundshëm edhe për gjashtë muaj, t'i përfundojë hetimet. Nëse Prokurori i Shtetit, nuk e ka hedhur kallëzimin penal brenda 30 ditësh dhe për 24 muaj nuk ka filluar dhe as përfunduar hetimet, ai nuk ka asnjë mundësi tjetër, përpos për ta hedh kallëzimin penal dhe për ta pushuar procedurën penale, pavarësisht se ai në aspektin formal, asnjëherë s'i ka filluar hetimet. Në të kundërtën, limitimi i kohëzgjatjes së hetimeve brenda 24 muajve nga ligjdhënësi, do jetë i pa efekt, ngase prokurorët s'do e hedhin kallëzimin penal brenda afatit prej 30 ditësh dhe pas 3-4 vjetësh do të marrin vendim për fillimin e hetimeve nëse vepra penale nuk është parashkuar, e pastaj do t'i këtë në dispozicion edhe dy vite, plus gjashtë (6) muaj për t'i përfunduar hetimet"*.
44. Në vijim të pretendimeve të tij parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Supreme në Mendimin juridik të 29 shtatorit 2016, kishte thekuar se nëse: *"Kallëzimi penal nuk është hedhur nga Prokurori i Shtetit brenda 30 ditësh, prokurori nuk mund të marr vendim për fillimin e hetimeve pas kalimit të 24 muajve, nga kalimi i afatit 30 ditor për hedhjen e kallëzimit penal. Përndryshe, limitimi në aspektin kohor i hetimeve do dilte i parëndësishëm-i panevojshëm, dhe me këtë do cenohej siguria juridike, standardi për gjykim në afat të arsyeshëm, pastaj do të dëmtohej i dyshuari për faktin se fillimi dhe kohëzgjatja e procedurës penale, prodhon pasoja juridike për të (ai ngelet i skeduar penalisht dhe mund të kufizohet në realizimin e shumë të drejtave që atij i takojnë sikur të mos ishte në proces)."*
45. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës pretendon se Prokurori i Shtetit nuk ka zbatuar Mendimin juridik të Gjykatës Supreme, meqenëse aktakuza ishte ngritur pas 34 muajsh e 13 ditësh, rrjedhimisht thekson në rastin e tij nuk është zbatuar ligji nga gjykatat e rregullta. Në vijim, parashtruesi i kërkesës thekson se Mendimi juridik i 29 shtatorit 2016 është publikuar 68 (gjashtëdhjetë e tetë) ditë para se të vendosej në gjykatën e shkallës së parë.

46. Sa më sipër, parashtruesi i kërkesës pretendon se të gjitha aktvendimet me të cilat i janë refuzuar kërkesat për rishikimin e procedurës penale, janë nxjerrë në shkelje të ligjit, sepse: *“Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren RLN/nr. 112/2018 i datës 07.05.2018, në arsyetimin e tij ai thotë që i dënuari ka bërë kërkesë për rishikimin e procedurës me datë 30.01.2018, që nuk është e vërtetë kjo është bërë me 31.10.2017 dhe ka provën e lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës me 17.10.2017, pra 32 ditë më vonë se ka marrë formën e prerë të aktvendimit, duke abuzuar me detyrën zyrtare. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës thekson se, i kishte shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sa i përket interpretimit të ligjit për termin “Person zyrtar” sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës: “në fillim nga Gjykata Kushtetuese, e pastaj sipas udhëzimit të saj në të gjitha shkallët e gjykatave të rregullta, ku asnjëra prej tyre nuk pranon të bëjë interpretimin e ligjit duke u shmangur me argumente të turpshme”.*
- ii. Pretendime përkitazi me “barazinë para ligjit”*
47. Përveç pretendimeve të mësipërme parashtruesi i kërkesës pretendon se gjatë procesit gjyqësor është ndjerë i diskriminuar për shkak të përkatësisë së tij fetare, duke theksuar se gjatë procesit gjyqësor janë bërë *“... dallime fetare si thirrja e dëshmitarëve katolik me detyrim paraqitje, ndërsa dëshmitarët e besimit myslimanë edhe pse nuk vinin, nuk lëshohet Urdhëresë për detyrim paraqitje (...). I vetmi nga të gjithë të akuzuarit unë jam katolik dhe i vetmi unë jam dënuar, mund të shikohet dosja”.*
48. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata, si në vijim: *“të jem i barabartë përpara ligjit, të mos vazhdoj të ndjehem i diskriminuar dhe i poshtëruar për interesat e njerëzve të pandërgjegjshëm dhe të papërgjegjshëm”.*

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 24

[Barazia para Ligjit]

- “1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
- 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
- 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato”.*

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- “1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
- 3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik*

ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

4. Çdokush i akuzuar për veprë penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

5. Çdokush i akuzuar për veprë penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.

7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit".

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

Neni 14

(Ndalimi i diskriminimit)

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

KODI I PËRKOHSHËM PENAL I KOSOVËS **(Publikuar më 6 korrik 2003)**

Neni 343

Marrja e ryshfetit

1. Personi zyrtar i cili kërkon ose merr dhuratë a përfitim tjetër për vete ose personin tjetër ose që pranon premtimin për dhuratë ose për ndonjë përfitim tjetër për të kryer në kuadër të autorizimeve të tij një veprim zyrtar apo një veprim tjetër të cilin ai nuk duhet ta kryejë ose të mos e kryej një veprim zyrtar apo veprim tjetër të cilin ai duhet ose ka mundur ta kryejë dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

2. Personi zyrtar i cili kërkon ose pranon dhuratë ose përfitim tjetër për vete ose për personin tjetër apo që pranon premtimin për dhuratë ose në ndonjë përfitim tjetër për të kryer në kuadër të autorizimeve të tij një veprim zyrtar apo veprim tjetër të cilin ai është dashur ta kryejë ose të mos e kryejë një veprim zyrtar apo një veprim tjetër të cilin ai nuk duhet ta kryejë, dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

3. Personi zyrtar i cili pas kryerjes ose moskryerjes së një veprimi nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni kërkon apo pranon dhurata ose ndonjë përfitim për vete apo për personin

tjetër në lidhje me kryerjen apo moskryerjen e tillë dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

4. Dhurata apo përfitimi tjetër që është marrë konfiskohen.

Neni 345 Ushtrimi i ndikimit

1. Kushdo që kërkon, merr ose pranon një ofertë ose premtim të një përparësie të padrejtë për vete ose për personin tjetër në lidhje me ushtrimin e një ndikimi të paduhur nga ana e kryerësit mbi vendimmarrjen e një personi zyrtar, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ushtrimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

2. Kushdo që premtion, ofron ose i jep në mënyrë direkte apo indirekte çfarëdo përparësie të padrejtë personit tjetër i cili ushtron ose konfirmon se ai është në gjendje të ushtrojë një ndikim të paduhur mbi vendimmarrjen e personit zyrtar, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ushtrimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

KODI Nr. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 309

Pranimi i ryshfetit në sektorin privat

1. Kushdo që drejton ose punon në cilësinë e një subjekti të sektorit privat ose që punon si person i vetëpunësuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë kërkon ose merr ndonjë dhuratë të pamërituar ose keqpërdor pozitën ose premtimin nga dikush ose pranon një ofertë ose premtim për një dhuratë apo shpërblim të tillë, për vete ose për një person tjetër, me qëllim që të veprojë ose të mos veprojë në shkelje të detyrës ose të funksionit të tij gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, financiare ose tregtare, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

2. Dhurata apo shpërblimi konfiskohet.

KODI NR-04/L-123 I PROCEDURËS PENALE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 418

Mjetet e jashtëzakonshme juridike

1. Pala mund të kërkojë rishikimin e procedurës penale brenda dy vjetësh nga aktgjykimi i formës së prerë ose aktvendimi i formës së prerë për pushimin e procedurës penale. Pala i paraqet kërkesën gjykatës themelore e cila ka nxjerr aktgjykimin e formës së prerë, e cila ia përcjell të gjitha kërkesat e vlefshme Gjykatës Supreme.

2. Pala mund të kërkojë zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit në çdo kohë gjatë periudhës së mbajtjes së dënimit, por jo kur kanë mbetur edhe gjashtë (6) muaj deri në përfundim të dënimit me burgim. Pala i paraqet kërkesën Gjykatës Themelore e cila ka nxjerr aktgjykimin e formës së prerë, e cila ia përcjell të gjitha kërkesat e vlefshme Gjykatës Supreme.

3. Pala mund të paraqesë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë brenda tre (3) muajsh nga aktgjykimi i formës së prerë ose aktvendimi i formës së prerë kundër të cilit kërkohet mbrojtja e ligjshmërisë. Pala paraqet kërkesën në Gjykatën Themelore e cila ka nxjerr aktgjykimin e formës së prerë, e cila ia përcjell të gjitha kërkesat e vlefshme të Gjykatës Supreme.

Neni 423

Rishikimi i procedurës penale të përfunduar me Aktgjykim të formës së prerë

1. Procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet vetëm nëse:

- 1.1. provohet se aktgjykimi është mbështetur në dokument të falsifikuar ose në deklaram të rremë të dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit;
- 1.2. provohet se aktgjykimi është pasojë e veprës penale të kryer nga gjyqtari ose personi që ka ndërmarrë veprimet hetimore;
- 1.3. zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja, të cilat vetë ose së bashku me provat e mëparshme ka të ngjarë të arsyetojë pafajësinë e personit të dënuar ose dënimin e tij sipas një dispozite më të butë penale;
- 1.4. personi për të njëjtën veprë është gjykuar disa herë ose kur disa persona janë dënuar për veprë të njëjtë të cilën ka mund ta kryejë vetëm një person ose disa prej tyre; ose
- 1.5. në rastin e dënimit për veprë penale në vazhdim ose vepra tjera penale të cilat sipas ligjit përfshijnë disa veprime të njëjta ose të ndryshme, zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja që tregojnë se i dënuari nuk ka kryer veprimin që është përfshirë në veprën penale për të cilën ai është dënuar dhe ekzistimi i fakteve të tilla do të ishte me ndikim vendimtar në caktimin e dënimit.

2. Procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet vetëm në favor të të pandehurit, përveç nëse vërtetohet që rrethanat nga paragrafi 1. nën-paragrafët 1.1. dhe 1.2. të këtij neni janë pasojë e veprës penale të kryer nga i pandehuri ose personi që vepron në emër të tij kundër një dëshmitari, eksperti, përkthyesi, prokurori të shtetit ose gjyqtari apo të 172 të afërmve të tyre, me ç'rast procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet kundër të pandehurit. Rishikimi i procedurës penale kundër të pandehurit lejohet vetëm brenda pesë (5) vjetëve nga koha e shpalljes së aktgjykimit të formës së prerë.

3. Në rastet nga paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1. dhe 1.2. ose paragrafi 2. i këtij neni, me aktgjykim të formës së prerë duhet vërtetuar se personat e tillë a janë shpallur fajtorë për veprat penale përkatëse. Kur procedura kundër këtyre personave nuk mund të zbatohet për shkak se kanë vdekur ose ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale, faktet nga paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1. dhe 1.2. ose paragrafi 2. i këtij neni mund të vërtetohen edhe me prova të tjera.

Pranueshmëria e kërkesës

49. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

50. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

51. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale) dhe 48 (Saktësimi i kërkesës), të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individit mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

52. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i njëjti konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml. nr. 151/2022] e 14 prillit 2022 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu në substancë ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit.
53. Tutje, Gjykata shqyrton nëse kërkesa i përmbush kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në nenin 49 të Ligjit, që përcakton:

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...”.

54. Përveç kriterëve të mësipërme, Gjykata po ashtu shqyrton nëse kërkesa përmbush kriteret e përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], në rastin konkret specifikisht me nënregullat (1), (2) dhe (3, b) të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, [...]

[...]

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:

[...]

(b) kërkesa nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën”;

[...]

55. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi

me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'i referohet të njëjtave, si "pretendime qartazi të pabazuara". Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime "të shkallës së katërt"; (ii) pretendime që kategorizohen me një "mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes"; (iii) pretendime "të pambështetura apo të paarsyetuara", atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih rastin e GjEDNj-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës KI166/20, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime "konfuze dhe të paqarta" (shih, rastet e GjEDNj-së, [Kemmache kundër Francës](#), nr. 17621/91, kategoria (i), [Juta Mentzen kundër Lituaniës](#), nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, kategoria (iii)).

56. Gjykata, fillimisht rikujton se në procedurën e shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, duke iu referuar praktikës së saj gjyqësore dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GjEDNj), thekson se ajo nuk është e kushtëzuar vetëm nga karakterizimi i shkeljeve që pretendon parashtruesi i kërkesës. Në frymën e parimit *juris novit curia*, Gjykata është vetë përgjegjëse për karakterizimin e çështjeve kushtetuese që mund t'i përmbajë një rast i veçantë dhe mund të shqyrtojë vullnetarisht ankesat përkatëse, bazuar në dispozita ose qëndrime që nuk thirren shprehimisht nga palët (shih, në këtë drejtim, rasti Gjykatës: [KI48/18](#), parashtrues: *Ahmet Frangu*, Aktgjykim i 22 korrikut 2020, paragrafi 81).
57. Përveç kësaj, sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, ankesa karakterizohet nga faktet e përfshira në të, dhe jo vetëm nga baza ligjore dhe argumentet në të cilat palët thirren shprehimisht (shih, rastin e GjEDNj-së: [Talpis kundër Italisë](#), nr. 41237/14, Aktgjykimi i 18 shtatorit 2017, paragrafi 77 dhe referencat e cituara aty).
58. Gjykata, bazuar në shkresat e lëndës vëren se esenca e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, në thelb ka të bëjë me: (ii) barazinë para ligjit dhe (i) pretendime për parregullsinë e procesit gjyqësor.
59. Andaj, pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do t'i shqyrtojë dhe analizojë nga pikëpamja e të drejtave të garantuara me nenin 24 dhe 31 të Kushtetutës, duke aplikuar parimet e përcaktuara nëpërmjet praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në bazë të të cilave Gjykata në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e obliguar që: "Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

i. Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me pretendimet për shkelje të parimit të "barazisë para ligjit"

60. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në lidhje me këtë pretendim thekson se gjatë procesit gjyqësor janë bërë “... *dallime fetare si thirrja e dëshmitarëve katolik me detyrim paraqitje, ndërsa dëshmitarët e besimit myslimanë edhe pse nuk vinin, nuk lëshohet Urdhëresë për detyrim paraqitje (...). I vetmi nga të gjithë të akuzuarit unë jam katolik dhe i vetmi unë jam dënuar, mund të shikohet dosja*”.
61. Gjykata në lidhje me këtë pretendim i referohet praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, e cila thotë se “diskriminimi do të thotë trajtim ndryshe, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, të personave në situata relativisht të ngjashme” (shih, GjEDNj, rastin [Willis kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr.36042/97, Aktgjykimi i 11 qershorit 2002, paragrafi 48; [Bekos dhe Koutropoulos kundër Greqisë](#), nr. 15250/02, Aktgjykimi i 13 marsit 2006, paragrafi 63, shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës [KI166/20](#), parashtrues: *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim i 5 janarit 2021, paragrafi 44).
62. Më tej, Gjykata rikujton se në mënyrë që pretendimet e parashtruesit në lidhje me shkeljen e të drejtës për mos diskriminim të jenë të suksesshme, parashtruesi i kërkesës *inter alia*, duhet të dëshmojë se pozita e tij mund të konsiderohet e ngjashme me pozitën e një personi tjetër i cili ka pasur trajtim më të mirë (shih, GjEDNj, rastin [Fredin kundër Suedisë](#), nr.12033/86, Aktgjykim i 18 shkurtit 1991, paragrafi 60, shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës [KI166/20](#), cituar më lart, paragrafi 45).
63. Gjykata në lidhje me këtë pretendim të ngritur në substancë nga parashtruesi i kërkesës, konsideron se i njëjti nuk ka paraqitur asnjë dëshmi e cila do të mund të provonte se përgjatë procesit gjyqësor ka pasur me të vërtetë diskriminim, përkatësisht se i njëjti është trajtuar ndryshe me ndonjë palë tjetër në një situatë të njëjtë ose të ngjashme e cila mund të ketë përfituar nga ndarja e drejtësisë në kushte të njëjta, dhe kjo nuk rezulton as nga shkresat e lëndës. Për më tepër, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës e ka ndërtuar pretendimin e tij për diskriminim mbi bazën e religjionit, gjegjësisht të besimit fetar të cilit i përket, por duke mos shpjeguar tutje se përse një pretendim i tillë do të ishte i bazuar për shkelje të së drejtës së garantuar me nenin 24 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 14 të KEDNj-së.
64. Rrjedhimisht, bazuar sa më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe dokumentet e paraqitura nga ai, Gjykata, duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e Gjykatës dhe praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk i ka mbështetur në asnjë mënyrë pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNj.
65. Andaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, duhet të deklarohen të papranueshme si qartazi të pabazuara pasi që këto pretendime kualifikohen si pretendime që hyjnë në kategorinë (iii) pretendime të *pambështetura apo të paarsyetuara*, në baza kushtetuese.
66. Rrjedhimisht, kërkesa në lidhje me këto pretendime duhet deklaruar e papranueshme si qartazi e pabazuar, në pajtim me nënregullin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

ii. Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me pretendimet për parregullsinë e procesit në ndërlidhje me kërkesën e II-dytë për rishikimin e procedurës penale

67. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, në lidhje me këtë procedurë, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

68. Megjithatë, para se të shqyrtoj çështjen nëse e drejta e parashtruesit të kërkesës gëzon mbrojtje nga Kushtetuta dhe KEDNJ, Gjykata bazuar në nenin 49 të Ligjit, duhet të vlerësojë paraprakisht nëse kërkesa është dorëzuar brenda afatit 4 (katër) mujor. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet rregullit 39, nënrrregullit (1), shkronjës (c) të Rregullores së punës, që përcakton: “c) kërkesa parashtrrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur **vendimi i mjetit të fundit** efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, [...]”
69. Në këtë këndvështrim, Gjykata bazuar në shkresat e lëndës vëren se procedura ndaj parashtruesit të kërkesës në lidhje me kërkesën e II-dytë për rishikimin e procedurës penale, kishte përfunduar me Aktgjykimin [Pml. nr. 370/2021] e 4 nëntorit 2021 të Gjykatës Supreme. Parashtruesi i kërkesës këtë Aktgjykim e kishte pranuar më 2 dhjetor 2021, që i bie se nga data e pranimit, e deri te parashtrimi i kërkesës në Gjykatë më 21 qershor 2022 kanë kaluar me tepër se 4 (katër) muaj. Andaj, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit të kërkesës në lidhje me kontestimin e vendimeve gjyqësore që ndërlihdhen me kërkesën e II-dytë për rishikimin e procedurës penale është dorëzuar jashtë afatit kohor prej 4 (katër) muajve.
70. Rrjedhimisht, në këtë pjesë kërkesa shpallet e paafatshme, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1,c) të Rregullores së punës.

iii. Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me pretendimet për parregullsinë e procesit, në lidhje me kërkesën e III-tretë për rishikimin e procedurës penale

71. Gjykata, rikujton se përkitazi me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës thekson se të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta, me të cilat i është refuzuar kërkesa për rishikimin e procedurës penale ndaj tij, janë nxjerrë në shkelje të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë dhe ligje të aplikueshme.
72. Sa i përket përmbushjes së kritereve të pranueshmërisë, në lidhje me këtë procedurë, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj dhe se kërkesën e ka dorëzuar brenda afatit 4 (katër) mujor, në pajtim me nenin 49 të Ligjit.
73. Megjithatë, në vazhdim Gjykata duhet të shqyrtojë nëse e drejta e parashtruesit të kërkesës për të cilën pretendon se i është shkelur nga autoritetet publike a gjykatat e rregullta, gëzon mbrojtje juridike nga Kushtetuta dhe KEDNJ.
74. Gjykata vë në dukje se, në lidhje me kërkesën III- tretë të parashtruesit të kërkesës, gjykatat e rregullta vendosën vetëm përkitazi me përmbushjen e aspekteve procedurale, përkatësisht ato vlerësuan nëse sipas ligjit ishin plotësuar ose jo kushtet për rishikimin e procedurës penale ndaj procedurës se përfunduar me Aktgjykimin [P. nr. 206/2015] e formës së prerë të 7 dhjetorit 2016 të Gjykatës Themelore.
75. Në dritën e kësaj, Gjykata sjellë në vëmendje Aktvendimin e saj në rastin KI50/18, ku kishte vendosur që pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me refuzimin nga ana e gjykatave të rregullta të kërkesës së tij për rishikimin e procedurës penale, nuk ishin *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën. (shih, po ashtu Gjykata Kushtetuese, rastin [KI186/18](#), parashtrues *Đeljalj Kazagić*, Aktvendimi i 29 majit 2017, paragrafin 66).
76. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se pajtueshmëria *ratione materiae* e një kërkesë me Kushtetutë rrjedh nga juridiksioni material i Gjykatës. Të drejtat në të cilat thirren

parashtruesit e kërkesave duhet të mbrohen me Kushtetutë, në mënyrë që një ankesë kushtetuese të jetë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën dhe, rrjedhimisht, brenda juridiksionit të Gjykatës (shih, Gjykata Kushtetuese, rastin [KI07/17](#), parashtrues *Pashk Mirashi*, Aktvendimi i 8 majit 2019, paragrafi 33).

77. Gjykata, në pajtim me praktikën e GJEDNj-së dhe praktikën e saj, rikujton se neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës dhe neni 6, paragrafi 1 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] i KEDNj-së, nuk zbatohen tek kërkesat për rishikim apo përsëritje të procedurës të cilat kanë rezultuar të pasuksesshme (Shih, në mënyrë analoge, rastet e Gjykatës Kushtetuese: [KI159/15](#), parashtrues *Sabri Ferati*, Aktvendimi i 13 qershorit 2016; rastet e bashkuara [KI80/15](#), [KI81/15](#) dhe [KI82/15](#), me parashtrues *Rrahim Hoxha*, Aktvendimi i 27 dhjetorit 2016; shih, *inter alia*, GjEDNj, rastin [Zawadzki kundër Polonisë](#), nr. 34158/96, vendimi i 6 korrikut 1999; [Sablon kundër Belgjikës](#), nr. 36445/97, vendimi i 10 prillit dhe [Steck-Risch dhe të tjerët kundër Lihtenshtajnit](#) (dec), nr. 29061/08, vendimi i 11 majit 2010, [Nistler kundër Austrisë](#), nr. 24912/08, Vendimi i 19 nëntorit 2013; [Dichev kundër Bullgarisë](#), , Vendimi i 27 janarit 2011).
78. Në këtë vazhdë, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNj-së e cila konstaton se neni 6.1 i Konventës nuk zbatohet në procedurat për rishikimin e ndonjë rasti, përkatësisht kur një person, dënimi i të cilit është bërë i plotfuqishëm, bën kërkesë për rishikimin e rastit të tij dhe gjatë kësaj procedure nuk është “akuzuar për vepër penale” (shih, GJEDNj-së, rastin [Franz Fischer kundër Austrisë](#), nr. 27569/02, Vendimi, i 6 majit 2003).
79. Në këtë këndvështrim, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me refuzimin nga gjykatat e rregullta të kërkesës së tij të tretë për rishikimin e procedurës penale, nuk janë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.
80. Për këtë arsye, Gjykata konsideron se kërkesa në këtë pjesë nuk i plotëson kriteret e kërkuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës, në pajtim me rregullin 39 (3, b) të Rregullores së punës është e papranueshme për shqyrtim të meritave të saj.

Përfundime

81. Si përmbledhje, Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, konkludon se: (I) pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, i takojnë kategorisë e tretë (iii), të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj si të tilla, në baza kushtetuese të njëjtat duhet shpallur qartazi të pabazuara; (II) kërkesa e parashtruesit të kërkesës përkitazi me pretendimet për parregullsi të procesit gjyqësor, në ndërlidhje me kërkesën II-dytë për rishikimin e procedurës penale, deklarohet e paafatshme në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1, c) të Rregullores së punës; (III) kërkesa e parashtruesit të kërkesës përkitazi me pretendimet për parregullsinë e procesit gjyqësor, në ndërlidhje me kërkesën III-tretë për rishikimin e procedurës penale nuk është *ratione materiae*, në pajtim me Kushtetutën.
82. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, në pajtueshmëri me konstatimet e mësipërme duhet deklaruar e papranueshme, në pajtim me rregullin 39, (1, c), (2) dhe (3, b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 dhe 49 të Ligjit, rregullin 39 (1, c), (2), (3, b) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 23 maj 2023, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- III. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Selvete Gërxhaliu-Krasniqi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani